

Kushtet e Veçanta për Sigurimin Term Life - DL080118

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, dhe këto Kushte të Veçanta për Sigurimin Term Life, në vazhdim Kushtet e Veçanta, janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës të cilin Kontraktuesi i Sigurimit e nënshkruan me Siguruesin.

Neni 2

Rasti i Siguruar

1. Sipas këtyre Kushteve të Veçanta, kontraktohet sigurimi në rast të vdekjes gjatë kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit.

Neni 3

Aplikimi i Kushteve

1. Kontrata përmes këtyre kushteve mund të lidhet në kohëzgjatje prej pesë e deri në tridhjetë vite.
2. Përmes këtyre Kushteve të Veçanta mund të sigurohen vetëm personat e shëndoshë prej moshës katërmëdhjetë vjeçare e deri në moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeçare, me çka personi i siguruar nuk mund të ketë më shumë se shtatëdhjetë e pesë vite me rastin e përfundimit të sigurimit.
3. Personat të cilët nuk e gëzojnë shëndetin e plotë dhe përbëjnë rrezik të shtuar për siguruesin mund të pranohen në sigurim vetëm përmes procedurave dhe kushteve të veçanta për rastet me rrezik të shtuar.

Neni 4

Pagesa e Primit

1. Primi paguhet paraprakisht, sipas afateve të kontraktuara, deri në skadimin e sigurimit. Në rast të vdekjes së Personit të Siguruar, gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, herën e fundit paguhet për muajin kur Personi i Siguruar ka vdekur.

Neni 5

Obligimet e Siguruesit

1. Në rast të vdekjes së Personit të Siguruar gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, Përfituesit të cekur në policë i paguhet:
 - a. 50% nga shuma e siguruar, nëse vdekja ka ndodhur brenda 6 muajit të parë të kohëzgjatjes së sigurimit
 - b. Shuma e siguruar nëse vdekja ka ndodhur pas 6 muajit të parë të kohëzgjatjes së sigurimit
2. Përfituesit nga paragrafi a. i pikës 1. të këtij neni, shuma e siguruar i paguhet tërësisht Përfituesit nëse:
 - a. Kontraktimi i sigurimit është bërë me kontroll paraprake mjekësore
 - b. Vdekja ka ndodhur si pasojë e aksidentit, në kuptim të Kushteve të Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale
 - c. Vdekja ka ndodhur si pasojë e shtatzënisë apo gjatë lindjes
3. Me përjashtim nga paragrafi a. i pikës 2. të këtij neni, nëse kontrata për sigurim është nënshkruar në afat prej 30 ditësh nga data e skadimit të sigurimit të mëparshëm me Siguruesin e njëjtë, dhe vdekja nuk ka ndodhur si pasojë e rrethanave të cekura në pikën 2. të këtij neni, atëherë Përfituesit i paguhet 50% e shumës së re të siguruar ose 50% e shumës së siguruar nga sigurimi i mëparshëm, varësisht se cila është më e lartë, por nuk mund të tejkalojë 100% të shumës së re të siguruar.

Neni 6

Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës

1. Në kontratat për sigurim të nënshkruara me këto Kushte të Veçanta zbatohen nenet e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës.
2. Nëse ka ndonjë mospërputhje në mes të ndonjërit nga dispozitat e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës dhe ndonjërit nga dispozitat e këtyre Kushteve të Veçanta, në marrëdhëniet nga kontrata për sigurim do të zbatohen dispozitat nga këto Kushte të Veçanta.